


SHENJTORI I DITES - Aleksandri, Pavli e Joani të Konstandinopojës. Oshënarët Fantini, Vriena. Dëshmorët Feliks episkopi, Januar presviteri, Fortunati dhe Septimini.



– Dëshmorët Feliks episkopi, Januar presviteri, Fortunati dhe Septimini –

Në vitin 294 doli një urdhër perandorak që të digjeshin tekstet e shenjta të të krishterëve. Ndaj, një sundimtar thirri shenjtoret të cilët jetonin në qytetin Tuvukja, u lexoi shkresën dhe kërkoi që t'i dorëzonin librat. Feliksi refuzoi menjëherë, sepse shkrimet na thonë: “Mos iu jepni gjërat e shenjtëruara qenve dhe as mos i hidhni margaritarët tuaj derrave”.

Sundimtari e quajti përgjigjen e tij tepër arrogante, prandaj e burgosi për 3 ditë pa bukë dhe pa ujë. Më pas përdori taktikën e lajkave, por nuk pati asnjë tërheqje nga shenjti. Ndaj e dërgoi te nënkonsulli romak së bashku me tre të krishterë të tjerë, presviter Januarin, Fortunatin dhe Septiminin, të cilët i hodhën në burg për 11 ditë. Pas kësaj i dërguan te Pretori i cili i futi për dy javë në një birucë të tmerrshme.

Më pas i hipën në një anije të lidhur në këmbë kuajsh, ku u dergjën pa bukë e pa

ujë për 4 ditë, derisa mbërritën në një port ku u kujdesën për ta në fshehtësi disa besimtarë. Nëpërmjet Taorminës së Sicilisë i çuan në Likaoni, në pjesën jugore të Azisë së Vogël, ku Pretori i zgjidhi dhe i kërkoi të bënin therore.

Meqë s'u lëkundën në vendosmërinë e tyre si të krishterë, ai i preu kokën, pasi më parë ata i ishin falur Perëndisë. Thuhet se, gjatë ekzekutimit të tyre, dielli dhe hëna u shndërruan në gjak. Një tjetër informacion tregon si vendin e martirizimit të tyre Romën ose Pulian e Italisë Juglindore.





- [Mitropolia e Shenjtë Korçë / Facebook](#)